



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## **KRYETARJA E GJYKATËS LUSHNJË, ESMERALDA ÇEKA NË SITËN E VETINGUT. KPK VAZHDON TË MOS JETË TRANSPARENTE NE LIDHJE ME DENONCIMET E PUBLIKUT.**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zhvilloi më 16 prill, ora 11:00 seancën dëgjimore me subjektin Znj. Esmeralda Çeka, Gjyqtare/Kryetare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Nga deklarata e ILDKPKI-së si dhe nga hetimi i pavarur dhe i thelluar i KPK-së për pasurinë, rezulton se Znj. Çeka ka bërë deklaram të saktë të pasurisë dhe në përputhje me ligjin. Ajo ka burime të ligjshme, nuk ka kryer fshehje të pasurisë dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 82.5 m<sup>2</sup> në Tiranë, subjekti ka deklaruar si burim një kredi në vlerën e 8.7 milionë lekë, një hua në vlerën e 12 mijë euro e marrë nga bashkëshorti dhe 5 mijë euro kursime. Në lidhje me huanë e marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, KPK ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit. Relatorja Znj Bungo afirmoi se shpjegimet e subjektit për huanë do të vlerësohen para marrjes së vendimit përfundimtar. Ndërsa Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë deklaroi se shtetasi që ka dhënë huanë, kishte mundësi ekonomike, dhe se për këtë ajo ka paraqitur dokumentacion pranë KPK në shpjegimet e saj me shkrim.

Sa i përket dy kritereve të tjera, atë të figurës dhe atë profesional, Kreu i Gjykatës së Lushnjës mori vlerësim pozitiv.

Në lidhje me pastërtinë e figurës, Esmeralda Çeka ka plotësuar saktë formularin dhe është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës. Sipas raportit të DSIK, nuk janë konstatuar kontakte të papërshtatshme të gjyqtarës me persona të lidhur me krimin e organizuar.

Ndërsa lidhur me aspektin profesional, KLD, ka dorëzuar një raport pranë Komisionit sipas të cilit gjyqtarja Çeka nuk ka asnjë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës, ajo ka aftësi të mira në arsyetimin dhe zbatueshmërinë ligjore, nivel të lartë etike dhe angazhim profesional.

Relatorja Bungo pohoi se ndaj subjektit ishin depozituar pranë Komisionit katër denoncime, por nga verifikimi i kryer ka rezultuar se nuk kishte indicie prej nga mund të ngriheshin dyshime se subjekti nuk ka respektuar procedurat. Edhe në këtë rast trupi gjykues nuk u tregua transparent në lidhje me to. Nga relatimi i çështjes nuk u kuptua natyra e tyre si dhe hetimi i komisionit. Relatorja deklaroi se do jepej shpjegimi gjatë vendimit përfundimtar.

Seanca dëgjimore u zhvillua në respektim të parimit për një proces të rregullt ligjor. Pas hetimit të thelluar, KPK-ja ka njoftuar subjektin për rezultatet, duke i kaluar dhe barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera.

Sipas relatores Komisioni i ka dhënë 7 ditë kohë subjektit për tu njohur me dosjen si dhe për të disponuar një kopje të saj. Ajo e ka ushtruar këtë të drejtë brenda afatit duke tërhequr një kopje. Subjekti ka paraqitur shpjegime dhe prova shkresore.

Kryetarja e Gjykatës së Lushnjës, Znj. Esmeralda Çeka i konsideroi të drejta gjetjet e Komisionit dhe në përfundim të seancës, kërkoi konfirmimin në detyrë.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Trupi gjykues i përbërë nga Etleda Çiftja, Pamela Qirko, Genta Tafa (Bungo) u tërhoq për vendim, i cili u shpall me 18 prill ora 9.30. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 16.04.2019 për subjektin e rivlerësimit, Znj. Esmeralda Çeka bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 05.04.2019 vendosi:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Esmeralda Çeka Kryetare e Gjykatës së Rrethit Lushnjë.

Këto janë të dhëna paraprake të referuara nga vëzhguesit e KShH-së. Raporti përfundimtar me gjetjet e plota për të gjitha seancat e monitoruara do të publikohet së shpejti nga KShH